



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2463

NR. VENDIMI 1608



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr.1369/ 2463 REGJ.THEM
1608 Vendimi

Nr.

Datë 03.06.2021

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTAR : ALBERT MEÇA

asistuar nga sekretare gjyqësore Mimoza Noka, në séancë gjyqësore, sot me datë **03.06.2021**, shpall këtë vendim lidhur me çështjen penale që i përket :

AKUZUES : Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përfaqësuar nga prokuror Enklid Gjini.

KUNDËR

IPANDEHUR : A***, i biri i *** arsim i mesem, beqar, i padenuar me pare, me shtetesi shqiptare, hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi “Arrest në burg”, përfaqësuar nga av. Robert Karati.

AKUZUAR : Për kryerjen e veprës penale të ”Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 pg.1 kodit penal.

Në diskutimin përfundimtar palët kërkuar :

Prokuroria : Të deklarojë fajtor të pandehurin A***për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve dhe në bazë të nenit 283/1 i Kodit Penal kërkoj dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimisht me 3 vjet e 4 muaj burgim. në zbatim të nenit 59 të Kodit penal pezullimin e pjesës së pavuajtur të dënimit dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës për një periudhë prove prej 3 vjet. Shpenzimet proceduriale në fazën e hetimeve paraprake t’i ngarkohen të pandehurit.

I pandehuri dhe avokati i tij deklaroi se është i penduar, një dënim sa më të butë dhe pezullimin e dënimit sipas parashikimeve të nenit 59 të Kodit penal.

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e palëve, shqyrtoi provat dhe çështjen në tërësi

VËREN

Se organi i prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur kërkesën për gjykimin e të pandehurit***duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 pg.1 i kodit penal, sipas të cilit :

Neni 283 pg.1 *“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet...”*

Nga ana e palëve në proces nuk pati pretendime lidhur me juridiksionin apo kompetencën dhe nga ana e Gjykatës nuk u konstatuan kryesisht pengesa procedurale në gjykimin e kësaj çështjeje. Nisur nga masa e dënimit e parashikuar nga dispozita për të cilën akuzohet i pandehuri, në zbatim të nenit 13 të Kodit të Procedurës Penale, çështja u gjykua nga një trup gjykues i përbërë nga gjyqtar i vetëm.

Nga***mor me arome dhe karakteristika te ngjashme me ate te lendes narkotike te llojit cannabis sativa.

Pas kontrollit te ambientit te lokalit, ne pjesen e nje paradhome qe komunikonte me tualetin u gjet nje pjate porcelani ne sipërfaqen e brendeshme te se ciles u konstatua nje sasi materiali pluhuri me te bardhe i vijeuar, me karakteristika te ngjashme me ate te lendes narkotike te llojit kokaine. Prej verifikimeve te kryera rezultoi se shtetasi Amarildo Harecari, ishte nen masen e sigurise "Arrest ne shiepi', ne kohen kur u gjet ne ambientet e lokalit.

Ne keto rrethana eshte bere shoqerimi te gjithë shtetasve per ne DVP Tirane per veprime te metejshrne procedurale.

Është bërë peshimi i qeses plastike transparente brenda te cilave ndodheshin pese qese te mbyllura me perdredhje dhe djegie, me lende te dyshuar narkotike te llojit Kokaine dhe te letres se verdhe, brenda te ciles ndodheshin pese qese te mbyllura me perdredhje dhe djegie, me lend***" Ne aferi te tualetit te lokalit eshte gjetur nje pjate porcelani ku ne pjesen e sipërme te saj ka pluhur te bardhe te dyshar si lende narkotike kokaine, cf are mund te me thoni per kete fakt? " iu pergjigj : " Pyetjen e kuptova dhe deklaroj se nuk kam dijeni se si ka perfunduar pjata ne ate vend, une di te them se une i kam sherbyer serviset per te konsumuar ushqimet qe ne ofrojm". Pyetjes "Mund te me thoni se kush mund ta kete derguar pjaten ne ate vend?" iu pergjigj : "Une nuke di". Deklaron se eshte perdorues jo i shpeshte dhe hera e fundit qe ka kosumuar kokaine eshte rreth 2 ose 3 jave me pare. Shton se shumicen e kohes punon vetem ne kete lokal dhe nuk arrin qe ta kontrolloj te gjithë ambjentin.

Ne vijim jane pyetur ne cilesine e personit ndaj te cilit kryhen hetime per kryerjen e vepres penale "Largimi i te burgosurit nga vendi i vuajtjes se denimit" parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal Amarildo Harecari i cili deklaroi : Diten e kapjes ne flagrance ka dale nga shtepia pasi jeton vetem ne mamane e tij Naime Harecari dhe kishte probleme shendetesore. Ka dale per ti blere disa ilace tek farmacia perballe shtepise dhe nga lokali i peshkut e kane thirrur disa shake te lagjes dhe ka shkuar per ti takuar. Mendoj qe ti takoj duke qene se eshte me mase sigurimi arrest ne shtepi dhe ka ndenjor ne lokal. Me pas ka ardhur policia dhe ka ushtruar kontroll ku gjate kontrollit atij nuk i kane gjetur ndonje send te kundraligjshem; Deklaron se nuk kishte dijeni se shtetasi Armando Hodaj kishte lende narkotike me vete dhe

e ka mesuar kur e kontrolluan punonjesit e policise. Deklaron se nuk kishte dijenise ne paradhomen e tualetit gjendej nje pjate me kokaine dhe nuk ka konsumuar lende narkotike ne ate lokal. Shton se per shkak te gjendjes shendetesore te renduar te mamase dhe duke qene se nuk ka njeri tjetër te perkujdeset per te, ndihet i penduar per veprimin qe ka bere.

I eshte marre deklarim ne cilesine e personit qe ka dijeni per vepren penale shtetasit Ibrahim Xhafa (Durollari) i cili deklaroi se: Diten e ngjarjes ka marre nje telefonat nga shoku i tij Klajdi Gjyla i cili i ka thene qe te shkoj te bej mbylljen e llogarise te restorantit, pasi Klajdi ndodhet ne Gjermani, me sa di ai eshte ortak me Aleksin. Rreth ores 21:30 ka shkuar tek lokali dhe ka pare qe ishte nje tavoline me disa persona dhe ka shkuar tek banaku ku ka takuar Aleksin dhe bashke me te ka bere mbylljen e llogarise te xhiros ditore. Ne kete moment kane hyre ne lokal disa punonjes policie dhe kane ushtruar kontroll, e kane kontrolluar dhe nuk i kane gjetur ndonje se****?" iu pergjigj "Armandin e njoh si cun lagje por une nuk kisha dijeni qe ai kishte lende narkotike me vete, kete fakt e kam mesuar kur kontrolloj policia". Pyetjes: "Ne kete lokal ne afersi te tualetit eshte gjetur nje pjate porcelani ku mbi te kishte lende te dyshuar kokaine, mund te me thoni kishit dijeni per kete fakt? " iu pergjigj : " Une nuk kisha dijeni per kete pjate dhe nuk e di fare pasi nuk kam shkuar fare ne tualet."

I eshte marre deklarim ne cilesine e personit qe ka dijeni per vepren penale shtetasit Taulant Durollari i cili deklaroi se: Diten e ngjarjes ka qene me shoket e tij ne lokal peshku dhe kane qene te ulur ne tavoline me te njohurit e tij Elmas Saliu dhe Adriatik Kaci, ku ishin duke konsumuar ushqim. Rreth ores 22:00 kane hyre disa punonjes policie brenda ne lokal duke u ushtruar kontroll, ku jane ngritur ne kemb, i kane ushtruar kontroll dhe atij, nuk i kane gjetur ndonje send te kundraligjshem, kane kontrolluar dhe personat e tjere qe gjendeshin ne lokal dhe kur kane kontrolluar*** ku i kane gjetur nje sasi kokaine. Nuk kishte dijeni per lenden narkotike qe i kane gjetur shtetasit Armando Hodaj dhe e ka mesuar kur punonjesit e policise e kontrolluan. Nuk ka dijeni per pjaten qe eshte gjetur ne paradhornen e tualetit dhe nuk ka pare njeri te konsumoje lende narkotike.

- ****MS per pluhurat e numertuara nga ana jone me numra nga 2 deri ne 9 objekt ekspertimi treguan per pranine e kokaines. Pesha e materialit pa ambalazh eshte 1.523 gram".

Vetë i pandehuri, nuk e ka kundërshtuar akuzën duke pretenduar se është përdorues i lëndës narkotike dhe lënda e gjetur ishte e tij. I pandehuri është shprehur i penduar dhe se kërkonte një dënim sa më të butë.

Sa më sipër Gjykata krijon bindjen se provat janë të plota, të harmonizuara dhe krijojnë bindjen se i pandehuri Armando Hodaj ka kryer veprën penale të mbajtjes së lëndëve narkotike parashikuar nga neni 283 pg.1 i kodit penal. I pandehuri me dashje ka mbajtur një sasi lënde të klasifikuar ligjërisht si narkotike pa qenë i pajisur me leje përkatëse apo për shkaqe të justifikuara.

I pandehuri me veprimet e tij të kundraligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme ka cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar kontrollin mbi lëndët narkotike dhe psikotrope si edhe rendin publik në përgjithësi. I pandehuri është në gjendje të kuptojë dhe kontrollojë veprimet e tij dhe pasojat që vijnë prej tyre, ka mbushur moshën 18 vjec dhe prandaj duhet të përgjigjet penalisht.

Në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit Gjykata mban parasysh rrezikshmërinë e

veprës dhe të të pandehurit. Kështu :

- Vepra penale e prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike po haset vazhdimisht dhe është një nga problemet shqetësuese i realitetit shoqëror shqiptar,
- I pandehuri është në moshë të re,
- Sasinë dhe llojin e lëndës narkotike të gjetur të pandehurit,
- Rrethanat e gjetjes së saj,
- Faktin se i pandehuri është përdorues i lëndëve narkotike
- Mënyrën e jetesës së të pandehurit si edhe
- Qëndrimin pohues dhe pendues të të pandehurit.

Duke i marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e mësipërme, Gjykata vlerëson se i pandehuri Armando Hodaj duhet të dënohet me burgim se lloji i vetëm i dënimit të parashikuar nga neni 283 pg.1 i kodit penal.

Nisur nga disa rrethana lehtësuese si pohimi dhe pendimi i të pandehurit që në momentet e kontrollit e në vijim, lloji dhe sasia e lëndës së mbajtur, rrethanat e mbajtjes së saj, mënyra e jetesës së të pandehurit (sipas akteve të Bashkisë Tiranë ai është djalë i rregullt, prindërit e tij janë të dy mësues), gjendja e tij familjare, moshën e re të të pandehurit dhe faktin se sipas akteve të Prokurorisë është i padënuar më parë, Gjykata krijon bindjen se qëllimi i dënimit penal mund të realizohet edhe me anë të dënimeve alternative sipas parashikimeve të nenit 59 dhe 60 të Kodit penal.

Në bindjen e brendshme të Gjykatës ndikon edhe fakti se tashkë i pandehuri ka kryer një pjesë të dënimit të tij me kohën e kaluar në paraburgim dhe se organ i Prokurorisë kërkoi aplikimin e nenit 59 të kodit penal duke pezulluar periudhën e pavuajtur të dënimit.

Për shkak të gjykimit me procedurë të shkurtuar, i pandehuri përfiton edhe uljen e 1/3 së dënimit sipas parashikimeve të nenit 406 të K.pr.penale.

Meqenëse Gjykata vlerëson se duhet pezulluar pjesa e pavuajtur e dënimit, në zbatim të parashikimeve të nenit 261 dhe 389 të k.pr.penale duhet të urdhërohet heqja e masës së sigurimit dhe lirimi i të pandehurit, pasi në nenet e mësipërme parashikohet se :

“Me vendimin e pafajësisë a të pushimit, gjykata urdhëron lirimin e të pandehurit të paraburgosur dhe deklaron heqjen e masave të tjera të sigurimit. Në të njëjtën mënyrë disponohet edhe kur vendoset pezullimi me kusht i vendimit”.

Lidhur me provat materiale, qarkullimi i lëndës narkotike është i ndaluar dhe në zbatim të nenit 190 të k.pr.penale duhet të urdhërohet asgjësimi i saj.

Për këto arsye, Gjykata krijoi bindjen dhe bazuar në nenin 379 dhe 390 të K.Pr.penale

VENDOSI

Deklarimin fajtor të të pandehurit A*** (i biri i*** për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 pg.1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim.

Në zbatim të nenit 406 të K.pr.penale ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri ***j dënohet me 3 (tre) vjet 4 muaj burgim.

Bazuar në nenin 59 dhe 60 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të pjesës së pavuajtur të këtij dënimi, me kusht që i pandehuri A***për një periudhë prove prej 4 (katër) vjet të mos kryejë vepër tjetër penale, të mos konsumojë lëndë narkotike, të mos

shoqërohet me persona të dënuar si edhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës.

Në zbatim të nenit 261 dhe 389 të k.pr.penale masa e sigurimit “arrest në burg” në ngarkim të të pandehuri***caktuar nga Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 192 rregj them, datë 04.02.2021, deklarohet e hequr dhe urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit ***i biri i ***nga ambientet ku mbahet i ndaluar, nëse nuk mbahet i arrestuar, i ndaluar apo i dënuar për ndonjë shkak tjetër.

Bazuar në nenin 190 të k.pr.penale prova materiale 2.4 (dy pikë katër) gramë kokainë dhe 0.8 (zero pikë tetë) gramë lëndë narkotike cannabis sativa me gjithë ambalazh të asgjesohet, pasi të përfundojë procedimi ndaj bashkë të pandehurve të tjerë.

Shpenzimet proceduriale i ngarkohen të pandehurit***

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi nga i pandehuri dhe/ose prokurori në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve.

U shpall me 03.06.2021.

S E K R E T A R E
Q T A R

G J Y

Mimoza Noka
ALBERT MEÇA

Shpenzime proceduriale hetimore 15.000 leke